

RAPORT TEKNIK

MBI PROJEKTIN "KANALIZIMI UJRAVE TE ZEZA" FSHATI TRASHOVICE

Ne mbështetje të detyres së projektimit të dhënë nga komuna Pishaj, u krye projekti i zbatimit "Kanalizimi ujrave të zeza" në fshatin Trashovice

Fshati Trashovice është një fshat i komunës Pishaj rreth 3 km nga Qyteti Gramsh në anën tjetër të lumit Devoll, që e ndan këtë fshat me rrugën nacionale Elbasan-Gramsh.

Popullsia aktuale - 516 banorë

Nr familjeve - 96

Shtesa natyrore e popullatës - 2%

Familje - 96

Aktualisht nuk ka asnjë lloj investimi lidhur me disiplinimin e ujrave të zeza, trajtohen në mënyrë individuale.

Në këtë projekt është parashikuar ndërtimi i rrjetit kanalizimeve të ujrave të zeza në të gjitha zonat e banuara.

Në këtë projekt është bërë parashikimi i grumbullimit të ujrave të zeza në dy drejtime, në dy linja, linja e parë që përfshin piketat 1-10 dhe linja e dytë që është dhe me gjatë pik 11-22 përfshirë dhe linjat e dyta, sekondare, dhe për dy linjat është parashikuar ndërtimi i gropave septike përkatësisht me përmasa 8x6x4m dhe 15x6x4m.

Është parashikuar që pusetat do të ndërtohen për grup familjesh, por edhe një apo dy familje në funksion të terrenit apo kuotave

Dendësia < 300 banorë/ha

Norma harxhimit për banorë - 150 l

Linja e lagjes jugore (Linja kryesore pik. 1-8)

Banorë 90 $N_{25} = N_{fakt} (1+p)^*$ Banorë - $90 * 1.49 = 135$

Ujë i pijshëm $q_1 = 134 * 150l/dite$ $q_1 = 0.23 l/s$

Ujrat e zeza = $2 * q_1 = 0.46 l/sek$

Ujrat e bardha $250x50 = 1250m/2 * 30 l/s = 7.5 l/s * 0.25 = 1.87 l/s$

Shuma e $Q = 2.33 l/s$ nga tabela zgjedhim diam. minimal të përdorshëm d- 200 mm PE AD Sn-4

Linja e lagjes veriore pik 11-21, pik 41-21, pik 26-14

Banorë 425 $N_{25} = 426 * 1.48 = 635$ banorë .. pas 25 vjetësh

Ujë i pijshëm $q_1 = 635 * 150 l/dit = 1.10 l/s$

Ujra të zeza $2 * q_1 = 2.2 l/s$

Ujra të bardha Q_j (pik 26-14, 11-21 dhe 41-21) = 1100 ml $S = 5500 m/2$

$Q_j = 5.5 * 30 l/s = 4.01 l/s$

Ujrat Mikse $Q_{max} = 6.6 l/s$

Nga tabela marrim tubo d- 200 mm plastik të brinjëzuara PE AD Sn-4, minimalisht

LLOGARITJET HIDRAULIKE K.U.Z. TRASHOVICE

Linja I (piketa 8-1-Gs)

Nr.P	Lparciale	Lprogr	K.Tokes	K.projekt	I pjerresia	h m	dj mm	Tip	H pus m

ING. S. SHEMSIU
PROJ. S/VIZIUM
KOLAUBI
[Signature]

8	0	0	258.14	255.14		0	200	PE -AD Sn-4	3 m
7	42	42	247.06	244.06	21.62%	11.08	200	PE -AD Sn-4	3 m
6	43	85	242.74	241.74	5.40%	2.32	200	PE -AD Sn-4	1 m
5	29.23	114.23	241.67	240.67	3.86%	1.07	200	PE -AD Sn-4	3 m
4	33.46	147.69	236.27	235.27	10.16%	5.4	200	PE -AD Sn-4	3 m
3	32.67	180.36	232.81	231.81	4.47%	3.46	200	PE -AD Sn-4	3 m
2	36.68	217.04	228.6	227.6	6.03%	4.21	200	PE -AD Sn-4	3 m
1	22.47	239.51	224.7	223.7	8.46%	3.9	200	PE -AD Sn-4	3 m

Linja II Piketa 11-21

Nr.P	Lparciale	Lprogr	K.Tokes	K.projekt	I pjerresia	h m	dj mm	Tip	H pus m
11			244.65	241.65			200	PE -AD Sn-4	3 m
12	28.15	28.15	240.52	239.52	7.57%	2.13	200	PE -AD Sn-4	3 m
13	32.67	60.82	235.05	234.05	10.62%	5.47	200	PE -AD Sn-4	3 m
14	24.18	85	232.39	231.39	2.73%	2.66	200	PE -AD Sn-4	3 m
15	36.53	121.53	228.49	227.49	5.2%	3.9	200	PE -AD Sn-4	3 m
16	31.56	153.09	225.2	224.2	4.09%	3.29	200	PE -AD Sn-4	3 m
17	29.14	182.23	220.5	219.5	9.26%	4.7	200	PE -AD Sn-4	3 m
18	40.44	222.67	218.26	217.26	0.59%	2.24	200	PE -AD Sn-4	3 m
19	35.8	258.47	215.47	214.47	2.21%	2.79	200	PE -AD Sn-4	3 m
20	35.8	294.27	211.99	210.99	4.13%	3.48	200	PE -AD Sn-4	3 m
21	44	338.27	203.2	202.2	19.86%	8.79	200	PE -AD Sn-4	3 m

Linja pik 41 - pik 21

Nr.P	Lparciale	Lprogr	K.Tokes	K.projekt	I pjerresia	h m	dj mm	Tip	H pus m
41			216.13	213.13			200	PE -AD Sn-11	3 m
42	59.5	59.5	204.98	203.98	15.38%	9.15	201	PE -AD Sn-12	1 m
43	77.5	137	204.65	203.65	0.43%	0.33	202	PE -AD Sn-13	1 m
44	49	186	204.47	203.47	0.37%	0.18	203	PE -AD Sn-14	1 m

SHEMSIU
SVIZION
18.07

45	49	235	204.15	203.15	0.65%	0.32	204	PE -AD Sn-15	1 m
46	49	284	203.95	202.86	0.59%	0.29	205	PE -AD Sn-16	1 m
47	56	340	203.71	202.71	0.27%	0.15	206	PE -AD Sn-17	1 m
48	52	392	203.54	202.54	0.33%	0.17	207	PE -AD Sn-18	1 m
21	46	438	203.2	202.2	0.74%	0.34	208	PE -AD Sn-19	1 m

Per ujrata e bardha eshte parashikuar qe rreth 25 % e tyre te perfundojne ne linjen e ujrave te zeza pasi pjesa tjeter duke pasur prasysh dhe terenin dhe pjesen qe absorbohet nga trualli dhe bimesia nuk mund te perfundojne ne kete kanalizim .

Per te ulur shpejtesije e rrjedhjes ne zona te caktuara ,m.q.se tereni ne disa segmente eshte i thyer eshte perdorur puseta tip kaskade , per te fituar kuote dhe te ulur shpejtesine . .

Linja ne total ne gjatesi eshte 2352 m nga te cilat tubo me Dj-200 L-2122m ; Dj-250 mm L- 230 m etj .

Tubot e kanalizimit jane zgjedhur tubo plastike tip PE AD SN-4 , te brinjezuar ,te cilet prodhohen per kete qellim posacerisht .

Lidhur me pusetat jane kryesisht dy llojesh per sa i perket lartesis ,per te ulur pjerresine faktike me lartesi nga aksi tubit 1.00m dhe 3 .00 m perkatesisht 29 cop dhe 27cop .

Jane parashikuar me beton M.200 dhe kapak betoni te armuar me beton M.250 Cimento eshte parashikuar te jete cimento A/sulfate me C3A dhe C4AF te kufizuar conform STASH. , me qellim per te rritur qendruesmerine e betonit ndaj agresivitetit te ujrave te zeza. Shtrimi i tyre eshte parashikuar ne kanale te hapur me h=1-3m ne funksion te lartesis ,kuotave ,mbi nje shtrese rere niveluese dhe mbuluese mbi tub.

Eshte parashikuar ndertimi i gropave septike ,perpunuese te ujrave te zeza , me dimensione a) 15*6 m , me dy dhoma e lartesi 3.8 m dhe b)8*6*4m Muret e brendshem jane parashikuar te suvatohen me llacimento 1:2 ,dhe ne kete rast perseri me cimento A/sulfate .

Per sa i perket konstruksioneve te ndryshme jane parahikuar per shaklet ,ganxhat e kapakeve etj , ndersa per sa i perket hekurit te punes cmimi eshte parashikuar brenda cmimit b.a.

M.q.se rreth 83. % e kanalizimit kalon neper rruget e fshatit te cilat jane me zhavor eshte parashikuar riparimi i tyre duke realizuar per zonen e kanalit te hapur shtrese zhavori 2x15 cm

Vlera punimeve parashikuese e objektit plus Fondin Rezerve te punimeve prej 5% se bashku me T v sh 20 % eshte 13 778 547 lek

Ing. /Sulejman SHEMSIU

S. Shemsiu
 ING. SULEJMAN SHEMSIU
 PROR. CIVILIC
 KALLIB, TALLOR

S. Shemsiu
 SHEMSIU

SPECIFIKIMI CMIMEVE

KANALI i UJRAVE TE ZEZA FSHATI TRASHOVICE

0. Instalimi dhe ngritja e kantjerit .

Ne kete cmim perfshihet kosto e ngritjes se kantjerit ,organizimi,ruajtja dhe magazinimi i materjaleve,ngritja e nje ngrehine te perkohshme ,paneli i afishimit te punimeve sipas modelit te dhene ,fotografimi gjate fazave te ndryshme te punimeve , nga fillimi deri ne perfundim te punimeve ; ripiketimi i objektit duke vene piketat sipas projektit dhe vendosja e numrave me boje te pashlyeshme ne vende te dukshme si shtylla ,peme,shkemb : berja e provave te ndryshme fiziko mekanike te materjaleve,te tubove plastic te brinjezuar , ,betoneve , b.a., shtresave etj konform K . T . Z . dhe STASH ne fuqi si dhe cdo gje tjeter qe lidhet me instalimin dhe cmontimin e kantjerit. Gjithashtu ne kete cmim perfshihet teresia e punimeve qe ka te beje me provat e ngarkeses ne linje komplet dhe ne pjese te vecanta . . Ky cmim perfshihet ne shpenzimet e pergjithshme qe duhet te perfshihen ne cmimin e cdo elementi ,brenda te cilit perfshihet dhe ardhura neto .

I. F.V. TUBO NE K.U.Z.

F.V. Tub plastik te brinjezuar PE AD SN 4 d- 250 mm

Ne kete cmim perfshihet teresia e punimeve qe ka te beje me blerjen e tubo plastic te brinjezuar ne PE-AD ,per sisteme lubrifikimi dhe shkarkesa te nendheshme me Dj-250mm, dhe qendrushmeri tubi SN > 4 KN/m²,conform prEN 13476-1 ;transportin ne veper ,shkarkomin,pergatitjen e tyre per montim duke perfshire te tere aksesoret apo materjalet e nevojshme si vendosja guarnicionit,manikotes , lubrifikimi dhe duke perdorur per bashkim mjete mekanike te dhena ne katollogun e ndermarjes prodhuese. Parashikohet montimi i tyre ,bashkimi,me njera tjetren sipas kushteve teknike perkatese deri tek vendosja e tyre mbi shtresen e reres .. Perfshihen provat me ngarkese te rrjetit .Per cdo parti furnizimi duhet bere shoqerimi me flete analizen perkatese nga uzina prodhuese ne te cilen te jete shenuar dhe dokumenti i daljes,faturimit. Cmimi eshte per 1 ml tub ne veper.

F.V. Tub plastik te brinjezuar PE AD SN 4 d- 200 mm

Ne kete cmim si me sipër perfshihet teresia e punimeve qe ka te beje me blerjen e tubo plastic te brinjezuar ne PE-AD ,per sisteme lubrifikimi dhe shkarkesa te nendheshme me Dj-200mm, I dhe qendrushmeri tubi SN > 4 KN/m²,conform prEN 13476-1 ;transportin ne veper ,shkarkomin,pergatitjen e tyre per montim duke perfshire te tere aksesoret apo materjalet e nevojshme si vendosja guarnicionit,manikotes , lubrifikimi dhe duke perdorur per bashkim mjete mekanike te dhena ne katollogun e ndermarjes prodhuese. Parashikohet montimi i tyre ,bashkimi,me njera tjetren sipas kushteve teknike perkatese deri tek vendosja e tyre mbi shtresen e reres .. Perfshihen provat me ngarkese te rrjetit .Per cdo parti furnizimi duhet bere shoqerimi me flete analizen perkatese nga uzina prodhuese ne te cilen te jete shenuar dhe dokumenti i daljes,faturimit. Cmimi eshte per 1 ml tub ne veper.

F.V. Tubo plastik PE-100 Dk-200 Pn-6

Ne kete cmim jepet teresia e punimeve qe kane te bejne me blerjen e tubove plastike me kerkesat teknike, sipas « I S O 9001 » , PE-100 pikerisht pas gropes septike per te larguar ujrat e tepert qe dalin ,transporti i tyre nga uzina prodhuese,shkarkimi ne veper,pergatitja per ne veper ,eshte parashikuar sigurimi i paisjeve ngjitese,salduese,per te siguruar procesin e

bashkimit te tubove me elektrodifuzion koke me koke ose bashkimi i tyre me fasheta plastike , parapregatitja e aneve te tubit per saldim,saldimi i tyre duke zbatuar me rigorizitet kerkesat teknologjike te ketij procesi si dhe cdo gje tjeter qe lidhet me kete proces pune .
Cmimi eshte per 1 ml tub plastic si me sipër ne veper.

II. PUNIME BETONESH NE KUZ

II.1 B.M 150 (shtrese nen puseta dhe dysheme gr,sept.) Ne kete cmim jepet teresia e punimeve qe ka te beje me blerjen,transportin e materjaleve inert te fraksionuar ,e lidhes,pergatitjen e betonit M.150 me 260 Kg/m³ cemento M.400 (cemento A/Sulfate me C3A dhe C4AF sipas STASH) me inerte rere 0.15-5mm 44% ,zal 15-20 mm dhe 20-40 mm ne masen 75% per 1m³, me rrjedhshmeri U/K-5-7cm :pergatitjen ,montimin dhe dizarmimin e armatures se derrases per elementin themele dhe shtresa me t-15cm dhe t-4 cm sipas projektit ,trajtimin e betonit konform K T Z 10/1-78 etj...Cmimi jepet per 1 m³ beton.

II. 2,3 B.M 200 (mure puseta dhe grop septike .) Ne kete cmim jepet teresia e punimeve qe ka te beje me blerjen,transportin e materjaleve inert te fraksionuar ,e lidhes,pergatitjen e betonit M.200 me 333 kg/m³ cemento M.400 (cemento A/Sulfate me C3A dhe C4AF sipas STASH) me inerte rere 0.15-5mm 44% ,zal 15-20 mm dhe 20-40 mm ne masen 75% per 1m³, me rrjedhshmeri U/K-5-7cm :pergatitjen ,montimin dhe dizarmimin e armatures se derrases ,trajtimin e betonit konform K T Z 10/1-78 etj.Jane parashikuar lenia birave e te daljes se tubove plastike ne muret e pusetave e gropes sipas drejtimit te linjes ne project dhe hermetizimi i tyre.Cmimi jepet per 1 m³ beton.

II.4 B/Arme M. 200 Ne kete cmim jepet teresia e punimeve qe ka te beje me proceset e mesiperme te pergatitjes se betonit M.200 per solete te gropes septike etj sipas projektit me 336 kg cim/m³ ,A/sulfate si me sipër , me zall 0.73 m³ me granulometri 5-20 mm ,rere 0.45m³ ; te blerjes se hekurit ,pergatitjen,vendosjen e tij ne veper ne veper konform projektit dhe KTZ 10/1-79 (duhet te jete i shoqeruar me certifikate cilesie dhe nga ana sipërmarresit te behen provat para betonimit ne laboratore te akredituar) Sasia e hekurit te betonit eshte marre 160 kg/m³ beton .

Cmimi eshte per 1 m³ beton M.200 te armuar ne veper.

II.5 B/Arme M.250 Ne kete cmim jepet teresia e punimeve qe ka te beje me proceset e mesiperme te pergatitjes se betonit M.250 per betonimin e kapakeve te pusetave sipas projektit me 362 kg cim/m³ , me zall 0.73 m³ me granulometri 5-20 mm ,rere 0.45m³ ; te blerjes se hekurit ,pergatitjen , betonimin e kapakeve me dopio zgare ,vendosjen e tij ne veper ne veper konform projektit . Cmimi jepet per 1 m³ beton.

III. PUNIME GERMIMI NE KUZ

III.1 Shtrese zhavori t-10-20 cm

Ne kete cmim perfshihet teresia e punimeve per blerjen,ngarkimin,transportin e perhapjen ne veper si shtrese te zhavorit te lumit me dimensione 0-60 mm si dhe nivelimin e tij ,ne neshtrinat e pusetave me h-10 cm dhe te gropes septike me h-20 cm. Cmimi jepet per 1 m³.

III.2 Shtrese zhavori 2 x15 cm ne rruge ,ngjeshje me rul . Ne kete cmim perfshihet teresia e punimeve per blerjen,ngarkimin, transportin, fraksionimin e perhapjen ne veper me 2 shtresa , shtresa pare 15 cm me dimensione 0-80 mm dhe shtresa e dyte 15 me dimensione 0-50 mm , cilindrimin e tyre ,ngjeshjen. me rul ne pjesen e hapur e demtuar nga hapja e kanalit . Cmimi jepet per 1 m² shtrese te perfunduar

III.3 Germim seksion detyruar dhe mbushje me dhe (kanal H-2.6 m)

ING. S. SHEMSIU
PROJ.+S/VIZION
KOLAUD.+LABOR

Ne kete cmim perfshihet teresia e punimeve qe ka te beje me germimin e hapjen e kanaleve te shtrimit te tubove ,lartesia e te cilit varion 1 dhe 3 m , ku perkatesisht 932 ml jane me h-3m dhe 1379ml me h-1m , perfshihet mbulimi i tij ,mbushja me ngjeshje , me dhe natyral deri ne kuoten nen 30 cm te nivelit te rruges pjese e cila do te mbulohet me zhavor kur kalon ne rruge ; mbushja me dhe te behet me shtresa dhe me ngjeshje per te eliminuar uljet e mundshme

Ne kete ze pune eshte parashikuar dhe germimi dhe largimi i dherave I vend ndertimit te pusetave dhe gropes septike etj... Cmimi eshte per 1 m/3 kub .

IV. PUNIME MURATURE DHE SUVATIMI NE KUZ

IV.1 Suvatim me llac ,cimento

Ne kete cmim jepet teresia e punimeve qe lidhen me me blerjen e materialit inert, rere per dore te pare e te dyte ,te cimentos M.400,te pergatitjes se llacit te cimentos me raport (1:2) sipas S.T.A.S H. 510/81, pastrimin paraprak te murevete gropes septike pergatitjen e skelave si dhe cdo gje qe lidhet me kete process . Trashesia e llac cimentos jo me pak se 2cm Cmimi eshte per 1 m/2 suvatim

V. TE NDRYSHME K U Z

V.1 Konstruksione metalike (d-16 mm shkalle dhe zgare)

Ne kete cmim parashikohet teresia e punimeve qe ka te beje me blerjen e materjaleve kryesore si llamarine,hekur C-31 s , profile mjete ndihmese si elektroda etj. Parashikohen pergatitja e tyre e vendosja ne veper konform projektit si e shkalleve ,detajeve metalike, menteshave etj si dhe cdo gje tjeter qe lidhet me kete process pune .Cmimi jepet per 1 ton konstruksion ne veper.

V.2 Shtrese rere mbi dhe nen tub

Ne kete cmim eshte pasur parasysh blerja e reres ,fraksionimi i saj me dim .0-5 mm ,transporti nga lumi Devoll,hapja dhe nivelimi ne shtresen e poshtme e te siperme te tubit sipas skices ne projekt , ze pune i cili do te percaktohet si detaj e material gjate punimeve te zbatimit ,pas hapjes kanalit . Cmimi jepet per 1 m/3 rere te ngjeshur ne veper

Ing. /Sulejman SHEMSIU/

Procurement
Albania

